

Nr. regj. 24896/2011

03-273-162
02
03.08.2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, gjyqtaria Azra Cakolli me procesmbajtësen Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Nexhmi(Shukri)Hyseni, nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 5, 6 dhe neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 27.07.2012 morri këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Nexhmi(Shukri)Hyseni, i lindur më 10.02.1956 në Breznicë Komuna e Dragashit, tani me vendbanim në Rugën "Ali Hadri", nr. 4, në Prishtinë, profesorë-doktor, Drejtorë i Klinikës së Kirurgjisë së fëmijëve, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse si zyrtarë i lartë publik, Drejtorë i Klinikës së Kirurgjisë së fëmijëve nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjorë 31 mars 2011, në Agjencinë kundër korrupsionit, sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, -

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5, 6 e neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, andaj i shqiptohet

D Ë N I M

Me gjobë në shumë prej 2000(dymijë) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjërin agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **30(tridhjetë) ditësh**.

Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar ta paguajnë shumën prej nga **5 €**, në afat dhe xhironlogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate kërkesën nr. 01-3231/2011 më datë 19.07.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartcekur për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke kërkuar që i njëjti të shpallët përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se rregullisht e ka deklaruar pasurinë, por për vitin 2011 askush nuk i ka pru aplikacionin për deklarim të pasurisë, andaj ka konsideruar se pa kërkesë nuk ka obligim për ta deklaruar. Konsideron se si drejtor nuk ka të bëjë me punë financiare dhe se obligimi i deklarimit të pasurisë sipas ti nuk është i arsyeshëm.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimin të deklaratës së të pandehurit, vlerësimin të provave të tjera secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja ka konstatuar se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë pasi që më afatin e paraparë ligjor deri 31.03 2012, nuk ka bërë deklarin e pasurisë ashtu si e parasheh ligji, andaj e shpalli përgjegjës dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë, andaj i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Regj. 24896/2011, më datë 27.07.2012

Gjyqtaria
Azja Caholli

VESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimin të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.